



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2951 prot.

Shkodër, më 29.08.2026

V E N D I M

Nr. 231, datë 29.08.2026

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT "DIPLOMË
PROFESIONALE 2-VJECARE "MENAXHER OPERACIONAL PËR TURIZËM DHE
MIKPRTJE" PËR PERIUDHËN 2027-2028**

Në mbështetje të Ligjit të AL me nr.80/2015 "Per Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa *dh*, nenet 73,75; Të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 17 pika 6 germa *f dhe* 52;54; VKM-në nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimeve të ofruara nga IAL-të" i ndryshuar; Udhëzimin e MAS nr.1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjet ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë"; me Vendim të SA-së nr.229 datë 18.08.2026, Bordi i Administrimit,

Vendosi:

1. Miratimin e programit të ri të studimit "Diplomë profesionale 2-vjecare" Menaxher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje" për periudhën 2027-2028, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka





Nr. 2432 Prot
dt 26.06.2026



Zj. E. Laci
Zj. M. Priku

26.06.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 801/11 prot.

Shkodër, më 26.06.2026

Lënda: Përcjellje e vendimit Nr.83, datë 24.06.2026 të departamentit Turizëm, i aprovimit të aplikimit të diplomës profesionale 2-vjeçare "Menaxher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje"

REKTORES SË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
PROF. DR. BLERTA DRAGUSHA

DREJTORISË SË KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË CILËSISË

Bashkëngjitur kësaj shkrese ju përcjellim vendimin Nr.83, datë 24.06.2026 të departamentit Turizëm, i aprovimit të aplikimit të diplomës profesionale 2-vjeçare "Menaxher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje".

Kjo shkresë përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë.

DEKANI

Prof.as.dr. Elidrisa Bashi





Mratolab

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI TURIZËM**

Nr 801 Prot

Shkodër, më 25.06.2026

V E N D I M
Nr.83 , datë 24.06.2026

**I APROVIMIT TË APLIKIMIT TË DIPLOMËS PROFESIONALE 2-VJEÇARE
"MENAXHER OPERACIONAL PËR TURIZËM DHE MIKPRTJE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; të Rregullores së Studimeve në USH; Rregullores së Fakultetit Ekonomik të USH; të Rregullores së Departamentit të Turizmit të FEUNISHK, Asambleja e Departamentit të Turizmit në mbledhjen e datës 24.06. 2026

VENDOSI:

- 1.Aprovimin e aplikimit të diplomës profesionale 2 vjeçare "Menexher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje"
- 2.Ky vendim i përcillet Dekanit të FEUNISHK.

Përgjegjëse e Departamentit të Turizmit
Arjeta Troshani
Prof.dr.Arjeta Troshani

Bashkëngjitur:

- 1.Aplikimi i diplomës profesionale 2 vjeçare "Menexher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje"
- 2.Skeda e Kodifikimit të Programit: Diplomë profesionale 2 vjeçare "Menexher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje"

APLIKIM

PËR HAPJE RIORGANIZIM PROGRAMI STUDIMI: **Diplomë Profesionale "Menaxher Operacional në Turizëm dhe Mikpritje"**



1. Institucioni/IAL Shkruani emrin e plotë të institucionit. Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"	2. Aplikimi (zgjidh një): Program i ri X ☐ Riorganizim programi ☐ Zgjidh llojin e programit: Program profesional X ☐ Bachelor ☐ Master profesional ☐ Master i shkencave/master i arteve ☐ Master i integruar i shkencave ☐ Master Ekzekutiv ☐ Specializim Afatgjatë ☐
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje/riorganizim. Shkruani emërtimin e plotë të programit. Diplomë Profesionale 2 vjeçare "Menaxher Operacionesh në mikpritje dhe turizëm"	
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes.: 2027-2028	
5. Të dhënat për aktin e hapjes/akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik. Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit.
7. Nëse është një program i përbashkët studimi identifikoj IAL-të bashkëpunuese dhe cito aktin e bashkëpunimit mes IAL-ve dhe marrëveshjen specifike për realizimin e programit të studimit.	
8. Programi ofrohet nga/në: Departamenti i Turizmit _____ Fakulteti i Ekonomik _____ Kampusi/godina_ Godina e Fakultetit Ekonomik _____	
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit: Emër, mbiemër: Arian Gjura Phd c Pozicioni në IAL: Anëtar i Departamentit të Turizmit Tel: +355694056956 E-mail: arian.gjura@unishk.edu.al	

10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore, të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

(Konfirmoj)

11. Seksioni A : Të dhëna mbi programin e studimit:

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- **Përshkrimi i përgjithshëm i programit, misionit, qëllimit dhe objektivave.**

Programi i studimit Diplomë Profesionale "Menaxher Operacional në Turizëm dhe Mikpritje" është një program profesional 2-vjeçar me 120 ECTS, i ndërtuar sipas kërkesave të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), Niveli 5 dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF).

Programi synon të përgatisë specialistë të nivelit operacional për sektorin e turizmit dhe mikpritjes, duke kombinuar formimin teorik me praktikën profesionale të integruar në biznese turistike, hoteleri, restorante, agjenci udhëtimi, struktura pritëse dhe organizata të menaxhimit të destinacioneve turistike.

Programi mbështetet në filozofinë e të nxënies përmes praktikës ("learning by doing") dhe zhvillon kompetenca profesionale, menaxheriale, digjitale dhe ndërpersonale të nevojshme për tregun bashkëkohor të punës.

Misioni

Misioni i programit është:

Të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri, veçanërisht në Rajonin Verior, përmes përgatitjes së profesionistëve të aftë për menaxhimin operacional të aktiviteteve turistike dhe hoteliere, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Qëllimi

Programi ka për qëllim:

- Përgatitjen e menaxherëve operacionalë të aftë për punësim të menjëhershëm në sektorin e turizmit dhe mikpritjes.
- Zhvillimin e kompetencave praktike për menaxhimin e proceseve të përditshme në hoteleri, restorante, agjenci turistike dhe struktura të tjera turistike.
- Përmirësimin e lidhjes ndërmjet universitetit dhe industrisë turistike.
- Rritjen e punësueshmërisë së të rinjve në sektorin me rritjen më të shpejtë ekonomike në Shqipëri.

Objektivat

Programi synon që studenti:

- Të fitojë njohuri bazë mbi turizmin e qëndrueshëm dhe mikpritjen.

- Të zhvillojë aftësi praktike në organizimin dhe ofrimin e shërbimeve turistike.
- Të përdorë sisteme rezervimi dhe platforma digjitale.
- Të komunikojë profesionalisht me klientë vendas dhe të huaj.
- Të zbatojë standarde të sigurisë, higjienës dhe cilësisë.
- Të organizojë evente dhe aktivitete turistike.
- Të menaxhojë situata operative në biznese turistike.
- Të zhvillojë aftësi sipërmarrëse dhe inovative në sektorin e turizmit.
- Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të destinacioneve turistike lokale.

- Lloji i programit, kohëzgjatja, numri i krediteve, etj.

Emërtimi i programit Diplomë Profesionale në "Menaxher Operacional në Turizëm dhe Mikpritje"

Cikli i studimit Program profesional

Niveli Niveli 5 i KSHK / EQF

Kohëzgjatja 2 vite akademike

Kredite 120 ECTS

Forma e studimit Me kohë të plotë

Gjuha e studimit Shqip

Diplomë e lëshuar Diplomë Profesionale

Praktikë profesionale 24 ECTS

Temë diplome / Provim përmbyllës 14 ECTS

Mundësi vijimi Certifikime profesionale dhe transferim kreditesh sipas legjislacionit në fuqi

- Njësia bazë / njësia kryesore ofruese e programit të studimit.

Njësia bazë ofruese e programit do jetë Departamenti i Turizmit, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Departamenti i Turizmit është njësia akademike përgjegjëse për zhvillimin e programeve të studimit në fushën e turizmit dhe mikpritjes, duke ofruar aktualisht programe Bachelor, Master Shkencor, Master Profesional dhe studime doktorale në fushën e turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Departamenti ka përvojë të konsoliduar në:

- zhvillimin e kurrikulave moderne në turizëm;
- bashkëpunimin me biznesin turistik;
- realizimin e praktikave profesionale;
- pjesëmarrjen në projekte Erasmus+, IPA dhe iniciativa ndërkombëtare;
- organizimin e konferencës ndërkombëtare CONF TOUR.

Pozicionimi i Universitetit të Shkodrës në rajonin me potencialin më të madh të turizmit natyror dhe kulturor në Shqipëri (Alpet Shqiptare, Thethi, Valbona, Vermoshi, Liqeni i Shkodrës, Velipoja dhe trashëgimia kulturore e Shkodrës) krijon një mjedis ideal për zhvillimin e këtij programi.

- 4. Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit.

4.1. Rëndësia e sektorit të turizmit

Turizmi përfaqëson një nga sektorët më dinamikë të ekonomisë shqiptare dhe një nga kontribuuesit kryesorë në GDP, punësim dhe zhvillimin rajonal.

Rajoni i Shkodrës dhe Shqipëria Veriore po përjetojnë një rritje të vazhdueshme të numrit të turistëve vendas dhe ndërkombëtarë, duke krijuar kërkesë në rritje për staf të kualifikuar në:

- hoteleri;
- restorante;
- agjenci turistike;
- guida turistike;
- organizim eventesh;
- menaxhim destinacionesh.

4.2. Konsultimet me industrinë

Në konsultimin e organizuar nga Departamenti i Turizmit me rreth 10 biznese të sektorit hotelier dhe turistik, bizneset evidentuan nevojën për një program profesional të orientuar drejt praktikës dhe punësimit të menjëhershëm.

Bizneset kërkuar që diplomanti të zotërojë:

- aftësi mikpritëse;
- komunikim profesional;
- gjuhë të huaja;
- njohuri mbi operacionet hoteliere dhe restorantore;
- aftësi digjitale;
- kulturë pune dhe disiplinë profesionale.

Gjithashtu, industria theksoi se praktika profesionale duhet të jetë elementi kryesor i programit dhe të zhvillohet gjatë gjithë periudhës së studimeve.

4.3. Evidenca nga tregu i punës

Studimi i tregut të punës në Shqipëri evidenton se sektori i shërbimeve është ndër sektorët me peshën më të madhe të punësimit dhe me kërkesë në rritje për fuqi punëtore të kualifikuar.

Po ashtu, dokumenti evidenton rëndësinë e lidhjes së programeve të studimit me nevojat reale të tregut të punës dhe rritjen e rolit të praktikave profesionale në procesin e punësimit.

4.4. Nevoja rajonale

Rajoni Verior i Shqipërisë po zhvillohet si një destinacion i rëndësishëm për:

- turizmin malor;
- turizmin kulturor;
- turizmin rural;
- agroturizmin;
- turizmin aventurë.

Megjithatë, bizneset raportojnë mungesë të vazhdueshme të personelit me kompetenca operative dhe menaxheriale, çka justifikon nevojën për krijimin e këtij programi profesional.

Analiza SWOT e aplikimit për hapje programi.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
- Eksperienca e Departamentit të Turizmit në programe universitare. - Staf akademik me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare. - Bashkëpunime të konsoliduara me biznesin turistik. - Pozicionimi në rajonin më turistik të Shqipërisë Veriore. - Mundësi të shumta për praktikë profesionale.	- Program i ri pa histori diplomimi. Nevoja për investime shtesë në laboratorë praktikë. - Perceptimi i disa maturantëve për programet profesionale si më pak prestigjioze - Varësia nga angazhimi afatgjatë i bizneseve partnere. Nevoja për monitorim intensiv të praktikave
Oportunitetet	Kërcenimet
Rritja e shpejtë e turizmit në Shqipëri. - Kërkesë e lartë për staf operacional në hoteleri dhe mikpritje. - Mbështetja e politikave kombëtare për arsimin profesional. - Partneritete me biznese dhe organizata ndërkombëtare. - Mundësi financimi përmes projekteve Erasmus+ dhe IPA.	- Emigrimi i të rinjve dhe mungesa e fuqisë punëtore. - Konkurrenca nga institucione të tjera të arsimit të lartë. - Ndryshimet sezonale të tregut turistik. - Luhatjet ekonomike që ndikojnë sektorin e turizmit. - Automatizimi i disa proceseve operative në sektor.

Ngarko informacionin

12. Seksioni B : Të dhëna mbi kriteret e pranimi në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët:

Kriteret e pranimi në programin e studimit.

Në programin e studimit Diplomë Profesionale "Menaxher Operacional në Turizëm dhe Mikpritje" pranohen kandidatë që plotësojnë kushtet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe aktet rregullatore të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
Kandidatët duhet të:

Kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë pajisur me diplomë shtetërore.

Të plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti i Shkodrës.

- Të aplikojnë nëpërmjet portalit U-Albania sipas procedurave kombëtare të pranimit.
- Të paraqesin dokumentacionin e kërkuar sipas afateve zyrtare.

Përzgjedhja e kandidatëve realizohet mbi bazën e:

- notës mesatare të arsimit të mesëm;
- kriterëve të përcaktuara nga Universiteti i Shkodrës;
- kuotave të miratuara për programin.

Për shkak të karakterit profesional të programit, prioritet mund t'u jepet kandidatëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në profile të lidhura me:

- Turizëm;
- Hoteleri-Turizëm;
- Shërbime;
- Ekonomi-Biznes;
- Gjuhë të Huaja.

Megjithatë, programi mbetet i hapur për të gjithë maturantët që plotësojnë kriteret ligjore të pranimit.

- Fusha e studimeve paraardhëse (në rastet e programeve të ciklit të dytë). Ky program është një program profesional i ciklit të parë (Niveli 5 i KSHK).

Për rrjedhojë:

Nuk aplikohet kriteri i fushës së studimeve paraardhëse, pasi pranimi realizohet drejtpërdrejt pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë.

- Numri maksimal i studentëve që do të pranohen:

Duke marrë në konsideratë:

- kapacitetet akademike të Departamentit të Turizmit;
- raportin pedagog/student;
- kapacitetet infrastrukturore;
- nevojën për zhvillimin e praktikave profesionale cilësore në bizneset partnere;

proponohet:

Kuota vjetore e pranimit: **50 studentë në vit akademik**

- Tarifa e studimit.

Duke qenë program profesional në universitet publik, proponohet:

Tarifa vjetore: 35,000 Lekë/vit

- **Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).**

Universiteti i Shkodrës do të zbatojë politikën kombëtare dhe institucionale të mbështetjes financiare për studentët.

Studentët e programit mund të përfitojnë:

1. Bursa për studentët me rezultate të larta

Studentët me rezultate të shkëlqyera akademike mund të përfitojnë bursë sipas akteve ligjore në fuqi.

2. Bursa sociale

Për studentët që vijnë nga:

- familje me ndihmë ekonomike;
- familje me të ardhura të ulëta;
- kategori sociale të mbrojtura.

Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.

Për kategoritë e përcaktuara nga ligji:

- persona me aftësi të kufizuara;
- jetimë;
- viktimë të trafikimit;
- kategori të tjera të mbrojtura.

Ngarko informacionin

13. Seksioni C: Plani mësimor/Kurrikula e programit të studimit:

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Numri total i krediteve.
- Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurrikulës dhe krediteve si më poshtë:
 - Lëndë të përgjithshme.
 - Lëndë karakterizuese.
 - Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese.
 - Lëndë plotësuese.
- Praktika profesionale.
- Detyrime përmbyllëse.
- Tema e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar.

Ngarko informacionin

Moduli, disiplina	Veprimtaria mësimore	Personelet akademike	Semestri	Kreditet ECTS	Nr. orë për leksione në auditor	Nr. orë për seminare në auditor	Nr. orë praktike	Nr. orë për studim individual
Semestri I								
1. Turizmi dhe mikpritja	A	Prof. a.s.dr. Mirjam Dibra	I	6	30	30	0	90

2. Bazat e Menaxhimit të Bizneseve Turistike	A	Dr. Alkida Hasaj	I	6	30	30	0	90
3. Komunikim Profesional në Mikpritje	B	Dr. Albana Berberi	I	6	30	30	0	90
4. Gjuhë e Huaj për Turizëm	B	Dr. Nivis Deda	I	6	30	30	0	90
5. Sjellje Profesionale në Turizëm dhe Mikpritje	B	Sead Baraku Phd ©	I	6	30	30	0	90
Totali Semestri I			I	30	150	150	0	450
Semestri II								
6. Siguria, Higjiena, Standardet dhe Ndihma e Shpejtë në Shërbim	B	Sead Baraku Phd ©; Vera Gjlnaj Phd ©; Dr. Emiljano Pjetri	II	6	30	30	0	90
7. Marketing Digjital dhe Sisteme Rezervimi	B	Prof. a.s.dr. Bërilanda Bushati	II	6	30	30	0	90
8. Promovim, Shitje dhe Marrëdhënie me Tregun në Turizëm	C	Gentjan Memaj, PhD c	II	6	30	30	0	90
9. Organizim Eventesh dhe Eksperiencash Turistike	C	Arian Gjura, PhD c	II	6	30	30	0	90

10. Praktikë I		Arian Gjura, PhD c	II	6	0	0	35	115
Totali Semestri II			II	30	120	120	35	475
Semestri III								
11. Operacione Hoteliere, Front Office	B	Prof.a s.dr.B rilanda Busha ti	III	10	45	30	30	145
12. Operacione Restoranti, Shërbim dhe Cilësi në Mikpritje	B	Dr.Romina Dhora	III	10	45	30	30	145
13. Menexhim te ardhurave në Turizëm	C	Dr.Arjeta Anamali	III	6	30	30	0	90
14. Lëndë me zgjedhje: a) Menaxhim i Burimeve Njerëzore Marlo Curcija ; b) Kulturë, Etnokulturë dhe Gastronomi Vendase Romina Dhora ; c) Turizëm Rural dhe Agroturizëm Arjeta Anamali ; d) Storytelling dhe Interpretim i Trashëgimisë Lokale Alma Hafizi ; e)Marketing Turistik Arjeta Troshani	C	Dr.Marlo Curcija; Dr.Romina Dhora; Dr.Arjeta Anamali; Prof.dr.Arjeta Troshani; Prof.a s.drAlma Hafizi;	III	4	15	15	0	70
Totali Semestri III			III	30	135	105	60	450
Semestri IV								

15. Praktikë Profesionale II		Gentjan Memaj, Phd c	IV	18	0	0	105	345
16. Projekt Profesional Përmbyllës / Provim Përmbyllës	E	Prof.dr.Arjeta Troshani	IV	12	0	0	0	300
Totali Semestri IV			IV	30	0	0	105	645
Totali				120	405	375	200	2020

14. Seksioni D: Personeli akademik dhe ndihmës akademik

Në këtë seksion shtjellohet një përmbledhje mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik të përfshirë me programin e studimit, duke përfshirë informacion mbi:

- Numrin e personelit akademik në njësinë bazë: 9 anëtar të stafit të brendshëm të Departamentit të Turizmit, FEUNISHK
 - Prof.dr.Arjeta Troshani
 - Prof.as.dr.Brilanda Bushati
 - Prof.as.dr.Mirjam Dibra
 - Dr.Alkida Hasaj
 - Dr.Romina Dhora
 - Dr.Arjeta Anamali
 - Arjan Gjura, Phd c
 - Sead Baraku, Phd c
 - Gentjan Memaj, Phd, c
- Numrin e personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesëshe).
- Numrin e personelit akademik të përfshirë në lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesëshe).
- CV-të e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore), angazhimin në program të personaliteteve të spikatura të fushës së studimit, etj.
- Numrin e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit – 2 laborantë
- Nëse programi i propozuar është inter-disiplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera.
 - Prof.as.dr.Alma Hafizi
 - Dr.Nivis Deda
 - Dr.Mario Çurçija
 - Dr.Alba Berberi
 - Dr.Emiljano Pjetri
 - Vera Gjinaj, Phd c

15. Seksioni E: Infrastruktura akademike në funksion të programit

Ky seksion përmban informacion të përmbledhur mbi infrastrukturën akademike në shërbim të programit të studimit, duke u fokusuar në:

- Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve.
- Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.
- Bibliotekë, numrin e titujve, numrin e posteve të leximit, e-library (nëse ka), etj.
- Zyrën për stafin akademik dhe ndihmës akademik.

Ngarko informacionin

16. Seksioni F: Programet e Përbashkët

Ky seksion plotësohet vetëm nëse programi i propozuar ofrohet në bashkëpunim me një institucion tjetër duke përfshirë edhe një përshkrim të nivelit të bashkëpunimit, duke iu përgjigjur elementëve të mëposhtëm:

- Burimet financiare dhe kontributi i partnerëve.
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët.
- Administrimi i programit.
- Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/e shumëfishtë).
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës.
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit.
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër.
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit.

Ngarko informacionin

17. Seksioni G : Analizë e tregut të punës

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapje/riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtarë, etj.
- Nevoja e pa përmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/riorganizuar i propozuar nga IAL-ja.
- Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.

- Punësimi potencial i studentëve.

Marrëveshje/kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

Sigurohuni që në analizë të përfshihen: (1) citime të plota për burimet e përdorura; (2) citime në tekst për burimet e përdorura; (3) adresat e burimeve online.

ANALIZË E TREGUT TË PUNËS

Programi i studimit me karakter profesional 2-vjeçar

“Menaxher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje”

Diplomë Profesionale, 120 ECTS, viti akademik 2027–2029

Qëllimi i analizës. Ky dokument përmirëson dhe zgjeron analizën ekzistuese të tregut të punës për programin profesional 2-vjeçar “Menaxher Operacional për Turizëm dhe Mikpritje”, duke e lidhur më qartë me: nevojën e papërbushur të tregut, avantazhet krahasuese ndaj programeve të ngjashme, trendet e punësimit, strukturat e ndërlidhjes me biznesin, punësimin potencial dhe dokumentimin e kërkesave/marrëveshjeve paraprake me operatorë privatë ose institucione publike.

Baza e brendshme e analizës. Analiza bazohet në dokumentin ekzistues të tregut të punës dhe në kurrikulën e programit. Kurrikula parashikon 120 ECTS në dy vite akademike, me module bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, praktikë profesionale dhe projekt/provim përmbyllës. Në planin e propozuar evidentohen lëndë drejtpërdrejt të lidhura me punësimin operacional: komunikim profesional, gjuhë e huaj për turizëm, sjellje profesionale, marketing digjital dhe sisteme rezervimi, operacione hoteliere/front office, operacione restoranti, promovim dhe shitje, organizim eventesh/eksperiencash, menaxhim të ardhurash, praktikë profesionale dhe projekt përmbyllës.

Burimet e jashtme. Për të garantuar gjurmueshmërinë e të dhënave janë përdorur burime zyrtare/statistikore: INSTAT për lëvizjet e shtetasve, strukturat akomoduese, statistikat strukturore të ndërmarrjeve dhe tregun e punës; AIDA dhe WTTC për kontributin ekonomik dhe punësimin në turizëm; World Bank, OECD, Eurostat dhe UN Tourism për kontekstin rajonal/ndërkombëtar, sezonizimin, investimet dhe rolin e turizmit në punësim.

1. Konteksti ekonomik dhe sektorial

Turizmi dhe mikpritja janë ndër sektorët me ndikim më të drejtpërdrejtë në punësim, sipërmarrje të vogla, shërbime vendore dhe zhvillim rajonal. Rritja e hyrjeve turistike, shtimi i strukturave akomoduese, zgjerimi i restoranteve dhe bareve, zhvillimi i turizmit rural/kulturor/natyror dhe përdorimi i platformave digjitale e kanë zhvendosur kërkesën e tregut nga “punonjës shërbimi” të përgjithshëm drejt profileve të afta për të kryer funksione operative të integruara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në Veri të Shqipërisë, ku potenciali turistik lidhet me Shkodrën, Alpet Shqiptare, Thethin, Vermoshin, Liqenin e Shkodrës, Velipojën, trashëgiminë kulturore dhe zhvillimin e agroturizmit.

Të dhënat e INSTAT tregojnë rritje të vazhdueshme të lëvizjeve turistike. Në gusht 2025, në territorin e Republikës së Shqipërisë hynë 3,368,104 shtetas shqiptarë dhe të huaj, 8.4% më shumë se në gusht 2024; vetëm hyrjet e shtetasve të huaj arritën 2,381,864, me rritje 9.9% vjetore (INSTAT, 2025a). Në dhjetor 2025, hyrjet e shtetasve të huaj arritën 698,742

dhe për periudhën janar-dhjetor 2025 arritën 12,466,038, kundrejt 11,696,111 në janar-dhjetor 2024 (INSTAT, 2026a).

Tregu i akomodimit po rrit kërkesën për staf të përgatitur. Në shtator 2025, struktura akomoduese regjistruan rritje të vizitorëve dhe netë-qëndrimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm; analiza ekzistuese evidenton rritje të vizitorëve me 31.7% dhe të netë-qëndrimeve me 19.6%. Ky trend krijon nevojë për punonjës të aftë në recepsion, rezervime, komunikim me klientin, sisteme digjitale, koordinim të shërbimeve dhe standarde cilësie (INSTAT, 2025b).

Në nivel ekonomik, pesha e turizmit është e lartë dhe rritja e tij krijon kërkesë për kapital njerëzor. AIDA raporton se në vitin 2024 sektori i turizmit në Shqipëri projektohet të kontribuojë 26.1% të PBB-së dhe të mbështesë rreth 278,100 vende pune, ose 21.8% të punësimit total (AIDA, 2025). WTTC gjithashtu e vlerëson sektorin e udhëtimit dhe turizmit si një nga kontribuesit kryesorë në ekonomi dhe punësim në Shqipëri (WTTC, 2024; WTTC, 2025).

2. Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektor

2.1. Trendi vendas. Punësimi në Shqipëri ka shfaqur përmirësim në treguesit e përgjithshëm të tregut të punës. Sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës, në tremujorin e dytë 2025 norma zyrtare e punësimit për popullsinë 15–64 vjeç ishte 69.1%, ndërsa papunësia e të rinjve 15–29 vjeç ishte 15.1%, me rënie krahasuar me vitin e mëparshëm (INSTAT, 2025c). Këto tregues sugjerojnë një treg pune në përmirësim, por edhe nevojë për programe profesionale që i ndihmojnë të rinjtë të hyjnë më shpejt në punë përmes aftësive praktike.

2.2. Turizmi si sektor punësimi. Turizmi krijon vende pune direkte në akomodim, ushqim, agjenci, guida, transport, evente dhe shërbime të lidhura, si dhe vende pune indirekte në furnizime, produkte lokale, teknologji, marketing dhe mirëmbajtje. Në strukturën e bizneseve shqiptare, INSTAT i trajton “akomodimin dhe shërbimin ushqimor” si kategori më vete në statistikat strukturore të ndërmarrjeve, çka konfirmon peshën e sektorit në ekonominë e shërbimeve (INSTAT, 2026b).

2.3. Trendi rajonal dhe evropian. Në nivel evropian, sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor karakterizohet nga përqindje e lartë punësimi, shumë ndërmarrje të vogla dhe nevojë për aftësi shërbimi me produktivitet më të lartë. Eurostat raporton se në BE në vitin 2022 ky sektor punësonte 10.9 milionë persona dhe përbënte 6.8% të punësimit në ekonominë e biznesit (Eurostat, 2025). Gjithashtu, Eurostat thekson sezonizimin e fortë të netë-qëndrimeve turistike në vende si Kroacia, Greqia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Shqipëria, duke e bërë të rëndësishme përgatitjen e stafit fleksibël për periudha piku dhe për menaxhim më të mirë të sezonit (Eurostat, 2026).

2.4. Rëndësia ndërkombëtare e aftësive në turizëm. Banka Botërore e konsideron turizmin një motor gjithëpërfshirës të krijimit të vendeve të punës, ndërsa në shkallë globale udhëtimi dhe turizmi mbështet rreth 357 milionë vende pune dhe rreth 10% të PBB-së globale në vitin 2024 (World Bank, 2025). Kjo e bën kualifikimin profesional në mikpritje, shërbim, komunikim dhe operacione një investim me vlerë për punësimin e të rinjve.

Burimi/Treguesi	Gjetja kryesore	Implikimi për programin
INSTAT – Lëvizjet e shtetasve, gusht 2025	3,368,104 hyrje në territorin shqiptar; +8.4% krahasuar me gusht 2024; 2,381,864 hyrje të shtetasve të huaj; +9.9%.	Rritje e kërkesës për staf në pritje, rezervime, informacion turistik, shërbim dhe komunikim shumëgjuhësh.

INSTAT – Lëvizjet e shtetasve, dhjetor 2025	12,466,038 hyrje të shtetasve të huaj në janar–dhjetor 2025, kundrejt 11,696,111 në 2024.	Turizmi nuk është vetëm sezonal; kërkon profile operative gjatë gjithë vitit.
